



Znj. Qëndrime Bregu

**DREJTOR I DREJTORISË SË BURIMEVE
NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**

Profili

Diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, dega Metrologji dhe Turizëm në Universitetin e Tiranës, znj. Qëndrime Bregu ka një përvojë të gjatë dhe të konsoliduar në administratën publike dhe sektorin financiar.

Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 1994 si mësuese, për të vijuar më pas si ekonomiste në institucione bankare dhe në sektorin privat të ndërtimit. Gjatë viteve 1999–2003 ka ushtruar funksione në sektorin bankar dhe në projekte pranë institucioneve shtetërore, duke fituar eksperiencë të gjerë në menaxhimin financiar dhe administrativ.

Prej vitit 2007 është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ku ka mbajtur pozicione si inspektore metrologe dhe specialiste finance, duke kontribuar në menaxhimin buxhetor dhe kontrollin financiar. Që nga viti 2018 ushtron detyrën e Drejtores së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, ku drejton proceset e menaxhimit të stafit dhe zhvillimit organizativ, me fokus në rritjen e eficiencës institucionale.

Gjatë karrierës së saj ka ndjekur një sërë trajnimesh profesionale në fusha si menaxhimi i investimeve publike, auditimi dhe kontrolli i brendshëm, standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik (IPSAS), si dhe hartimi dhe harmonizimi i legjislacionit, duke forcuar më tej kompetencat e saj profesionale.

qendrim.bregu@dpm.gov.al